

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "HOTELERI TURIZËM"

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Hotele Boutique janë struktura hoteliere: 1 pikë
- A) Shumë të vogla;  
B) Shumë të shtrenjta;  
C) Hotele elitare;  
D) Të tre alternativat e mësipërme.
2. Minimumi i gjerësisë së dyerve të ashensorit në hotel duhet të jetë: 1 pikë
- A) 120 cm;  
B) 90 cm;  
C) 70 cm;  
D) 80 cm.
3. Në ndërmarrjet e vogla e të mesme hoteliere, shefi i receptionit është edhe: 1 pikë
- A) Shefi i portenerisë;  
B) Shefi i katit;  
C) Shefi i lavanderisë;  
D) Shefi i restorantit.
4. Numri i personelit në sektorin e kuzhinën përcaktohet nga: 1 pikë
- A) Vendndodhja e strukturës akomoduese;  
B) Kategoria cilësore e strukturës akomoduese;  
C) Numri i punonjësve të strukturës akomoduese;  
D) Sektorët e tjerë të strukturës akomoduese.
5. Komunikimi i drejtpërdrejtë me klientët në hotel është formë e komunikimit: 1 pikë
- A) Diagonal;  
B) Horizontal;  
C) Poshtë-lart;  
D) Lart-poshtë.
6. Një klient në strukturën akomoduese, që paguan me mjete monetare në monedhë të huaj, përdor metodën e pagesës: 1 pikë
- A) Me kartë krediti;  
B) Me çek personal;  
C) Me pará në dorë (cash);  
D) Marrëveshje e drejtpërdrejtë.
7. Cili është veprimi që **NUK** do të ndërmerrnit, nëse klienti humb vetëdijen, pasi mbytet duke ngrënë ushqim: 1 pikë
- A) Do e nxitni të kollitet;  
B) Do e ulni në dysheme;  
C) Do lajmëroni urgjencën;  
D) Do filloni ringjalljen zemër-mushkëri.

8. Pjesa e etikës që merret me mënyrën se si një organizatë i përgjigjet mjedisit të brendshëm apo të jashtëm është: **1 pikë**
- A) Etika e punës;
  - B) Etika organizative;
  - C) Etika e biznesit global;
  - D) Etika e punonjësit.
9. Koncepti i një veprimtarie që përdoret për të krijuar të ardhura (para) është: **1 pikë**
- A) Ideja e shërbimit;
  - B) Ideja e produktit;
  - C) Ideja e biznesit;
  - D) Ideja e ofertës.
10. Pozicioni financiar i një firme, në të cilën paraqiten pasuritë dhe detyrimet, pra çfarë zotëron firma dhe çfarë ka borxh tregon: **1 pikë**
- A) Bilancin gjendjes ( gjendja financiare);
  - B) Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
  - C) Pasqyra e kapitalit të vet;
  - D) Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen monetare (cash flow).
11. Kostot që nuk varen nga sasia e produktit të prodhuar janë: **1 pikë**
- A) Kostot fikse;
  - B) Kostot ndryshueshme;
  - C) Kostot direkte;
  - D) Kostot indirekte.
12. Marrëdhënia bashkëveprimi midis blerësve dhe shitësve të një malli apo shërbimi, si dhe për përcaktimin e çmimit dhe sasisë së tregtuar përfaqëson: **1 pikë**
- A) Ofertën;
  - B) Kërkesën;
  - C) Tregu;
  - D) Produkte.
13. Tërësi e marrëdhënieve ndërmjet kërkesës dhe ofertës së mallrave dhe shërbimeve të përdorura për të përmbushur nevojat turistike të njerëzve është: **1 pikë**
- A) Kërkesa turistike;
  - B) Tregu turistik;
  - C) Oferta turistike;
  - D) Nevoja turistike.

14. "Udhëtime të përgjegjshme në zonat natyrore që ruajnë mjedisin dhe përmirëson mirëqenien e banorëve lokalë". do të thotë: **1 pikë**
- A) Turizëm;
  - B) Politikë;
  - C) Ekoturizëm;
  - D) Turist.
15. Tërësia e mjeteve, e objektivave dhe e ndërhyrjeve të ndërmarra për të rregulluar furnizimin e ekonomisë me mjete monetare në përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur ekuilibrat makroekonomike është: **1 pikë**
- A) Politika fiskale;
  - B) Politika kombëtare;
  - C) Politika turistike;
  - D) Politika monetare.
16. Struktura akomoduese është: **1 pikë**
- A) Elementë të ofertës turistike;
  - B) Elementë të kërkesës turistike;
  - C) Faktorët e ofertës;
  - D) Faktorët e kërkesës.
17. Bilanci kontabël pasqyron gjendjen e pasurisë, detyrimeve dhe kapitalit të vet ndërmarrjes në çastin e hartimit të tij, përgjatë një periudhe të caktuar që është: **1 pikë**
- A) Dita ushtrimore;
  - B) Muaji ushtrimor;
  - C) Viti ushtrimor;
  - D) 5-vjeçari ushtrimor.
18. Baza e një bilanci është gjendja, i ashtuquajtimi: **1 pikë**
- A) Inventar;
  - B) Aktivët;
  - C) Detyrimet;
  - D) Burimet e veta (kapitali i pronarit).
19. Qarko përgjigjen e saktë. **1 pikë**  
Të ardhura – ? = Rezultati (+ fitimi ose – humbje).
- A) Të ardhura;
  - B) Shpenzime;
  - C) Rezultati;
  - D) Pasuri.
20. Tatimi mbi vlerën e shtuar është: **1 pikë**
- A) TAP;
  - B) TVSH;
  - C) NIPT;
  - D) QKL.

21. Lidh me një shigjetë të dhënat e kolonës së parë me ato të kolonës së dytë.

4 pikë

1. Nevoja	a. Është gjithçka që mund të plotësojë nevojën/dëshirë.
2. Kërkesa	b. Çmimi për çdo produkt
3. Kosto	c. Është tërësia e kërkesave bazike për të përballuar jetesën.
4. Produkt	d. Mbështet aftësinë dhe gatishmërinë për të blerë.

22. Përmendni konceptet themelore të marketingut:

8 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_
- 5) \_\_\_\_\_
- 6) \_\_\_\_\_
- 7) \_\_\_\_\_
- 8) \_\_\_\_\_

23. Listoni elementë të ndryshëm ekonomik dhe jo ekonomik.

4 pikë

Shërbimet turistike krijohen nga një sistem kompleks turistik i cili është i përbërë nga elementë të ndryshëm ekonomik dhe jo ekonomik.

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

24. Listoni katër ndër faktorët kryesorë që e përcaktojnë kërkesën turistike:

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

25. Për të realizuar saktë detyrat e tij në hotel, receptionisti duhet të dijë në çdo moment të ditës këto të dhëna:

4 pikë

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

26. Renditni tre efektet pozitive të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe internetit (TIK) në aktivitetin hotelier: **3 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_

27. Lidhni me një shigjetë të dhënat e kolonës së parë me ato të kolonës së dytë. **3 pikë**

1. Pensionet	a. Vendosen në afërsi të stacioneve hekurudhore e porteve.
2. Hotelet tranzit	b. Janë miniapartamente me ambiente të përbashkëta, që u ofrohen klientëve për një shërbim strehimi të kompletuar.
3. Hostelet	c. Ofrojnë strehim për persona që qëndrojnë për periudha mjaft të gjata me çmime ekonomike.

28. Renditni detyrat që ka shefi i portenerisë në një ndërmarrje të madhe hoteliere. **6 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_
- 5) \_\_\_\_\_
- 6) \_\_\_\_\_

29. Të gjendet kapitali i pronarit. **2 pikë**

Një sipërmarrës kërkon të investojë në fushën e hoteleri-turizmit. Ai dëshiron të hapë një restorant. Ai ka disa kursime (mjete monetare =500000 lekë) dhe një ndërtesë me vlerë 1500000 lekë, ku të ushtrojë aktivitetin e tij. Bilanci i tij fillestar do të ishte me këtë paraqitje:

Aktive	Shuma	Pasive	Shuma
Mjete monetare	500.000	Kapitali i pronarit	?
Ndërtesa	1.500.000		
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>Totali i pasiveve</b>	2.000.000

Llogaritni:

1. Totalin e aktiveve
2. Kapitalin e pronarit

30. Plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme.

2 pikë

Amortizimi është \_\_\_\_\_ e vlerës që një \_\_\_\_\_ material pëson për shkak të përdorimit të tij me kalimin e kohës në një ndërmarrje.

